



REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL
PËR MARRJEN E SHKALLËVE TË KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE
TË LËNDËS MUZIKË
2020**

1. HYRJE

Aftësia e mësuesve për ta bërë arsimimin e nxënësve “preokupimin” kryesor të ditës, kërkon përkushtim, përgjegjshmëri dhe standarde të larta në punë dhe sjellje. Mësuesit veprojnë me ndershmëri dhe integritet, kanë njohuri të qëndrueshme përmbajtësore, përdorin dijet dhe aftësitë e tyre, por në të njëjtën kohë përditësojnë njohuritë nëpërmjet vetëvlerësimeve të vazhdueshme, krijojnë marrëdhënie pozitive profesionale dhe punojnë me prindërit në interesin më të mirë të nxënësve të tyre.

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve të lëndës së muzikës është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) për t’u ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve të lëndës së muzikës në përgatitjen për testimin kombëtar për marrjen e kategorive të kualifikimit, si dhe të gjitha Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar për të organizuar zhvillimin profesional për të gjithë mësuesit që do të hyjnë në këtë proces.

Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që MASR-ja ka vendosur për mësuesit që kualifikohen. Programi është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve janë:

- dokumente zyrtare¹, të cilat kanë të bëjnë me procesin e të nxënës;

¹ Dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MASR-së që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

- programe lëndore të muzikës;
- aspekte të pedagogjisë, të metodologjisë dhe të përdorimit të TIK në mësimdhënie-nxënie;
- aspekte të etikës dhe të komunikimit;
- aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- përmbajtja shkencore e lëndës, sipas programeve lëndore të muzikës.

2. QËLLIMI I PROGRAMIT

Qëllimi i hartimit të programit të zhvillimit profesional të mësuesve për efekt kualifikimi është:

- të ofrojë një program orientues për t'u ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve të lëndës së muzikës në arsimin parauniversitar për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese, si dhe DRAP-eve, ZVAP-ve, për të organizuar zhvillimin profesional të mësuesve. Në këtë aspekt programi mund të plotësohet nga DRAP-et, ZVAP-të, përkatëse, sipas kushteve dhe mundësive konkrete;
- të ofrojë një program të detyruar, për mësuesit që këtë vit do të marrin kategoritë e kualifikimit, në mënyrë që ata të përgatiten për të përballuar me sukses kërkesat që ka testimi kombëtar.

Programi synon që mësuesi:

- të njohë dhe të zbatojë legjislacionin arsimor sidomos, në mënyrë të veçantë, të risive më të fundit të reformës arsimore;
- të zotërojë kompetencat profesionale të kuadrit mësimdhënës, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor, për një mësimdhënie cilësore dhe të suksesshme;
- të demonstrojë aftësitë në fushën pedagogjike për përzgjedhjen e modeleve për organizimin e klasës, për shtjellimin e koncepteve, për nxitjen e diskutimeve, për përdorimin e teknikave të vlerësimit të nxënësve etj.;
- të tregojë përgjegjshmëri në njohjen e koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku ata japin mësim;
- të demonstrojë zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë;

- të zotërojë zbatimin e rregullave drejtshkrimore të gjuhës shqipe, gjatë procesit të mësimdhënie -nxënies.
- të përdorë aftësitë e TIK-ut, si një nga risitë më të fundit në mësimdhënien bashkëkohore.

3. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër. Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Për secilën fushë, përcaktohen:

- kompetencat profesionale, si dhe rezultatet e pritshme për realizimin e këtyre kompetencave;
- literatura përkatëse rekomanduese në funksion të përvetësimit të kompetencave të fushës.

Përshkallëzimi i njohurive dhe aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë të testimit, do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë çështjet në të cilat duhet të përqëndrohet.

| FUSHA “DOKUMENTACIONI ZYRTAR SHKOLLOR” | |
|--|---|
| Kompetenca “Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe dokumentacionit shkollor” | Literatura e rekomanduar |
| <p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i muzikës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • zotëron ligjin për sistemin arsimor parauniversitar dhe dispozitat normative të këtij sistemi; • zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore; • zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për personelin e shkollës; • demonstroi zbatimin konkret të udhëzimeve të MASR-së në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënie- | <ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. • Udhëzimi nr.18, datë 20.08.2019 “Për vitin shkollor 2019-2020 në sistemin arsimor parauniversitar”. • Udhëzimi nr. 30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”. • Udhëzimi nr. 1, datë 20.01.2017 “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve |

| | |
|--|--|
| <p>nxënies;</p> <ul style="list-style-type: none"> • zbaton etikën profesionale të mësuesit; • respekton të drejtat dhe liritë e nxënësit; • respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit; • zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit. | <p>arsimorë”.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Udhëzimi nr. 2, datë 12.02.2015. “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”. • Udhëzimi nr. 34, datë 11.09.2015 “Për vlerësimin e nxënësve për kurrikulën me kompetenca, në arsimin bazë”. • Udhëzimi nr. 14, datë 28.07.2016 “Për vlerësimin e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë”. • Urdhri Nr.6, datë 10.01.2018 për zbatimin e nismës “Tri lëndë në gjashtë orë”. |
|--|--|

| FUSHA: PROGRAME LËNDORE TË MUZIKËS | |
|---|--|
| Kompetenca “Zbatimi në mënyrë efektive i programeve të muzikës në shkollë” | Literatura e rekomanduar |
| <p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i muzikës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • zbaton programin duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tij; • përshtat programin lëndor në përputhje me veçoritë e mjedisit në të cilin jep mësim; • përdor me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetin dhe zbatimin e programit; • gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe aftësive të parashikuara në program; • gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që pasurojnë formimin e nxënësve dhe nxisin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre; | <ul style="list-style-type: none"> • Korniza kurrikulare, 2014. • Kurrikula bërthamë AMU, klasat VI-IX, 2014. • Programet me kurrikulën e bazuar në kompetenca, klasat VI-IX. |

| | |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none"> • harton rezultate të nxëni për tema mësimore ose grup temash, tematikash, në përputhje me rezultatet e të nxënit të programit; • kategorizon rezultatet e të nxënit të programit sipas niveleve të arritjes së të nxënit; • harton rezultate të nxëni specifike që u përgjigjen niveleve të ndryshme të nxënësve; • tregon koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe përshtatshmëria e programeve të muzikës); • shpjegon lidhjen program mësimor - tekst nxënësi; • përzgjedh mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e programit; • siguron informacion që demonstroi lidhjen e <i>muzikës</i> me shkencat e tjera dhe me jetën reale. | |
|---|--|

| FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK –ut NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE | |
|---|--|
| Kompetenca I “Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien e muzikës” | Literatura e rekomanduar |
| <p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i muzikës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • demonstroi përkushtim, motivim dhe përgjegjësi gjatë punës së tij; • përshtat punën e tij me zhvillimin <i>fizik, social, emocional</i> dhe <i>konjitiv</i> të nxënësve; • demonstroi respekt, besim dhe objektivitet me nxënësit; • identifikoi nxënësit me nevoja të veçanta (nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe nxënësit e talentuar); | <ul style="list-style-type: none"> • Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015. • Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët, 2017. • Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët, 2017 • Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në gjimnaz, 2016. • Udhëzues për kurrikulën me zgjedhje në gjimnaz, ASCAP 2018. |

| | |
|--|--|
| <ul style="list-style-type: none"> • planifikon punën afatshkurtër dhe afatgjatë me nxënësit me nevoja të veçanta; • demonstroi qëndrim pozitiv ndaj arteve dhe lëndës së muzikës; • edukon të nxënësit dëshirën dhe kuriozitetin ndaj lëndës së muzikës; • motivon nxënësit, duke e konsideruar motivimin një çelës të progresit të tyre; • krijon klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit; • punon me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit. | <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i nxënësit në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë. (<i>Material shpjegues në ndihmë të shkollave</i>), nëntor 2018. • Literaturë që ka në fokus aspekte pedagogjike të punës së mësuesit me nxënësit e tij. |
| <p>Kompetenca II</p> <p>Përdorimi i metodave dhe strategjive efektive në mësimdhënien e muzikës;</p> | <p>Literatura e rekomanduar</p> |
| <p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i muzikës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e një objekti të caktuar; • përdor metoda e teknika që nxisin mendimin e pavarur e krijues të nxënësve; • planifikon një orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin; • përdor metoda e teknika që nxisin zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve; • përdor metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen; • përdor proceset muzikore në mësimdhënien – nxënien e muzikës; • demonstroi teknika të ndryshme për vlerësimin e nxënësit; • shpjegon parimet e hartimit të një testi/detyrë përmbledhëse. | <ul style="list-style-type: none"> • Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët, 2017 • Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në gjimnaz, 2016. • Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), ASCAP 2016. • Udhëzues për kurrikulën me zgjedhje në gjimnaz, ASCAP 2018. • Vlerësimi i nxënësit në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë. (<i>Material shpjegues në ndihmë të shkollave</i>), Shtator 2019. • Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së muzikës në arsimin e mesëm të ulët dhe të lartë, dhjetor 2018. • Modele detyrash përmbledhëse për artet në arsimin parauniversitar (DP |

| | |
|---|--|
| | të hartuara nga mësuesit), Lënda: muzikë. |
| Kompetenca III Përdorimi i teknologjinë së informacionit dhe komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies në muzikë. | Literatura e rekomanduar |
| <p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i muzikës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • prezanton materiale muzikore, duke përdorur teknologji të përshtatshme si: Power Point, Finale, Word; • nxit nxënësit të bëjnë prezantime në muzikë, duke përdorur programe kompjuterike të njohura për ta; • gjen dhe përdor materiale nga website për të pasuruar dhe perfeksionuar mësimdhënie-nxënien në muzikë; • përfshin nxënësit në projekte kurrikulare të lëndës së <i>muzikës</i> apo në projekte kurrikulare të integruara për fushën e arteve, të cilat ndërthuren me kërkime, gjetje dhe përdorime materialesh nga website. | <ul style="list-style-type: none"> • Literaturë që ka në fokus përdorimin e programeve kompjuterike edhe në muzikë. |

| FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT | |
|--|--|
| Kompetenca | Literatura |
| “Zbatimi i rregullave të etikës dhe komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit” | |
| <p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i muzikës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • njeh rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e | <ul style="list-style-type: none"> • Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar. • Draft-Standardet profesionale të mësuesit në arsimin parauniversitar, |

| | |
|--|--------------------------------|
| <p>institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin;</p> <ul style="list-style-type: none"> • sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor. | <p>IZHA, (sot ASCAP) 2016.</p> |
|--|--------------------------------|

FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

| Kompetenca | Literatura |
|---|---|
| <p>“Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe”</p> | |
| <p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i muzikës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • njih rregullat e drejtshkrimit të standardit të gjuhës shqipe; • demonstroi zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor. | <ul style="list-style-type: none"> • Drejtshkrimi i gjuhës shqipe. |

FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS

| Kompetenca | Literatura e rekomanduar |
|---|---|
| <p>Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien e lëndës së muzikës</p> | |
| <p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i muzikës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • dallon konceptet dhe shprehjet kryesore me të cilat operon lënda e <i>muzikës</i> në klasat I-IX; • përshkruan mënyrën e formimit të njohurive muzikore; • përshkruan zhvillimin vertikal, nga njëri vit në tjetrin, të njohurive dhe të shprehjeve; | <ul style="list-style-type: none"> • Programe dhe tekste të lëndës së muzikës për mësuesin dhe nxënësin, si dhe materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës për klasat VI-IX për arsimin e mesëm të ulët. |

- | | |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none">• dallon ndërvarësinë dhe zhvillimin e koncepteve muzikore nga njëri - tjetri dhe lidhjen me konceptet e lëndëve të tjera;• zhvillon me kreativitet mënyra të ndryshme të zhvillimit të veprimtarive artistike të cilat përdorin konceptet dhe aftësitë e programeve I-IX;• mbledh informacion të saktë e bindës për nxënësit e tij rreth vlerave përdoruese të muzikës me artet e tjera dhe me shkencat e tjera dhe në jetën e përditshme. | |
|---|--|